

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA RINE OVA-LI-PUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK/DMP	Nr. Prot.	03-3073/13
Dep.		Prot. NO	
Nr. i faq.		D. 70	
Broj. stranica	02	Datim	27.09.2013
Nr. pages		Dat.	
PRISHTINE			

Regj. nr. 8006/12-4

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË DEGA NË PODUJEVË DEPARTAMENTI I PËRGJITHËSHM DIVIZIONI PËR KUNDERVAJTJE, gjyqtari duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit: Fidan Rekaliu nga Podujeva, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5 dhe 6 paragrafi 1 dhe 3 si dhe neni 9, e sanksionuar me nenin 17 paragrafi 1 pikë 3 të Ligjit Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050 e në bazë të neneve 9, 37, 73, 74, 195 dhe 199, të Ligjit mbi kundërvajtjet me dt. 08.08.2013 merr:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Fidan Nezir Rekaliu, i lindur me 25.01.1987 në Podujevë me vendbanim në Podujevë rruga "Ali Sadriu" i pa martuar, shtetas i Republikës së Kosovës, shqiptar me profesion student i masterit dhe Deputet i Forumit Rinor në KK-Podujevë me gjendje të mesme ekonomike

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Pasi që: si deputet i KK-Podujevës nuk ka bërë deklarin e pasurisë pran Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor deri me 31.03.2013 edhe pse ka qenë i njoftuar me kohë për këtë obligim. Deklarimin e pasurisë e ka bërë me datën 17.09.2012.

Me këtë veprim i pandehuri kreu kundërvajtje nga neni 5 dhe 6 paragrafi 1 dhe 3 si dhe neni 9 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, andaj duke u bazuar në nenin 17 paragrafi 1 pika 3 të këtij Ligji dhe nenit 9 pika 1 paragrafi 1 të LMK-së i pandehuri

N D Ë S H K O H E T

Me gjobë në shumë prej 300€ (treqind euro) të cilën gjobë është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga data ku aktvendimi bëhet i plotfuqishëm, në të kundërtën gjoba do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 20 ditësh, duke llogaritur nga 15 € për një ditë burgimi.

Gjithashtu në afatin e lartë cekur obligohet i pandehuri që gjykatës t'ia paguaj shumën paushallë 10 € (dhjetë euro) në të kundërtën arkëtimi bëhet me dhunë.

Një kopje e aktvendimi t' i dërgohet paraqitësit të kërkesës dhe të pandehurit.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit ka paraqitë kërkesën nr. 01-2537/12 të datës 13.07.2012 e regjistruar në gjykatën tonë me dt. 30.07.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse, kundër të pandehurit të lartë cekur.

Për vërtetimin gjendjes faktike gjyqtarja ka ftuar të pandehurin në gjykatë me datën 20.02.2013 për tu deklaruar për kundërvajtjen e cila i vuhet në barre, në deklaratën e tij i pandehuri ka theksuar se nuk kam deklaruar pasurinë në Agjencion deri me 31.03.2012 pasi që nuk jam njoftuar nga askush për këtë obligim, pastaj nga mjete e informimit e kam kuptuar dhe me datë 17.09.2012 jam shkuar dhe e kam deklaruar pasurinë në Agjencion. Si dëshmi gjykatës i ka dorëzuar vërtetimin e lëshuar nga Agjencioni Kundër Korrupsionit.

Gjithashtu nga ana e gjykatës në cilësinë e dëshmitarit është ftuar Zyrtari Kontaktues i AAK në Komunë z. Ragip Jaholli i cili në deklaratën e tij ka theksuar se i pandehuri me kohë ka qenë i njoftuar për

03-3073/13/02
fsg

obligimin e tij ligjor për deklarimin e Pasurisë në Agjencion dhe si dëshmi ka sjell në gjykatë listën e zyrtarëve të cilët kanë qenë të obliguar për deklarim në të cilën figuron edhe i pandehuri.

Pas administrimit provave dhe të shkresave që janë pjesë përbërëse e lëndës gjyqtarja ka vërtetuar në mënyrë të sigurt se i pandehuri nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë në afatin e paraparë ligjor deri me 31.03.2012 por atë e ka bërë disa muaj ma vonë me datën 17.09.2012 kjo vërtetohet nga vërtetimi i lëshuar nga Agjencioni të cilin pala e ka prezantuar në gjykatë. Kurse pretendimet e tij se nuk ka qenë i njoftuar me kohë për deklarim nuk qëndrojnë pasi që nga dëshmia e dëshmitarit është vërtetuar në mënyrë të padyshimtë se i pandehuri me kohë është njoftuar për obligimin e tij ligjor për deklarimin e pasurisë në Agjencion .

Me sa u tha më lartë u vërtetua se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vuhet barrë për të cilën u shpall përgjegjës dhe u ndëshkua si në diapozitiv të aktvendimit me të cilën gjohë mendjëm se do të arrihet qëllimi i dënimit dhe ne te ardhmen i pandehuri nuk do ta përsëris kundevajtjen .


Me rastin e shqiptimit të dënimit u morën parasysh rrethanat renduese dhe lehtësuese të përcaktuara në nenin 7 të LMK –se rrethana renduese nuk pati, kurse si rrethanë lehtësuese u mor parasysh gjendja ekonomike e të pandehurit sjella korrekte e tij në gjykatë se është hera e parë që ka kryer kundërvajtje ,kurse neni 9 pika 1 par 1 u aplikua për zbutjen e dënimit pasi që i pandehuri është student i studimeve master shqiptimi i ndonjë dënimi me të lart do të keqësonte pozitën e tij materiale dhe rrethanën se i pandehuri ka bërë ma vonë deklarimin e pasurisë dhe se qëllimi i tij nuk ka qenë që të mos e deklaroj pasurin .

Shpenzimet e procedurës u caktuan konform neni 110 të LMK-së

Me sa u tha u vendos si në diapozitiv të Aktvendimit .

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË DEGA NË PODUJEVË DEPARTAMENTI I PËRGJITHËSHM- DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE

Regj. nr. 8006/12-4 datë 08.08.2013



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi i pandehuri dhe paraqitësi i kërkesës mund t'i paraqesin ankesë në afatin ligjor prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi në Gjykatën e Apelit në Prishtinë Divizioni për Kundërvajtje nëpërmes të gjykatës tonë pa taksë.